



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr. _____, datë _____.____.2019

PËR

**DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.43/2015, “PËR SEKTORIN E
ENERGJISË ELEKTRIKE” TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 28 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1 shtohet një fjali me përmbajtje si më poshtë:

“Asetet e lidhjes që i shtohen rrjetit ekzistues janë pronësi e Operatorit të Sistemit të Transmetimit”.

2. Pikat 5 dhe 7 shfuqizohen.

Neni 2

Pika 1 e nenit 31, riformulohet si më poshtë:

“1. Linjat e reja të interkoneksionit që ndërtohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit që ushtron të drejtat e pronësisë mbi Operatorin e Sistemit të Transmetimit. Linjat e reja të interkoneksionit që ndërtohen nga investitorët privatë, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë.

Neni 3

Në pikën 2, të nenit 49, në fund të shkronjës “h”, shtohet shkronja “i”, me përmbajtje si më poshtë:

“i. zhvillimin e procesit konkurrues për miratimin e ndërtimit të kapaciteteve prodhuese të energjisë nga hidrocentralet”.

Neni 4

Pika 8 e nenit 60, riformulohet si më poshtë:

“ERE në ushtrimin e kompetencave të parashikuara në pikat 1, 6 dhe 7, të këtij neni, duhet të marrë mendimin nga ministri që ushtron të drejtat e pronësisë mbi Operatorin e Sistemit të Transmetimit.”

Neni 5

Në nenin 72 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1.Pika 3, germa a) riformulohet si më poshtë:

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet të ketë të drejta efektive të plota vendimarrëse, të pavarura nga shoqëria e integruar e energjisë elektrike, lidhur me asetet e nevojshme për funksionimin, mirëmbajtjen ose zhvillimin e rrjetit të Shpërndarjes.

Për të përmbushur këto detyra, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, përfshirë burimet njerëzore, teknike, fizike dhe financiare.

Shoqëria mëmë (kontrolluese), ka të drejtën e mbikëqyrjes ekonomike dhe menaxheriale në lidhje me kthimin e aktiveve, miratimin e planit ekonomik financiar, ose çdo instrument

ekuivalent, të operatorit të sistemit të shpërndarjes, dhe të vendosë kufijtë e përgjithshëm në nivelet e borxhit të shoqërisë bijë (të kontrolluar) .

Shoqëria mëmë (kontrolluese), nuk mund të japë udhëzime për veprimtarinë e përditshme operacionale të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së energjisë dhe nuk ka të drejtë të marrë vendime lidhur me ndërtimin apo rikonstruksionin e linjave të shpërndarjes, vlera e investimit të të cilave nuk tejkalon nivelet e planeve financiare të miratuara apo vlerat e përcaktuara në statutin e shoqërisë, apo legjislacionin në fuqi;

2.Pika 3, germa b) riformulohet si më poshtë:

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet të krijojë një program pajtueshmërie që përcakton masat që do të merren për të siguruar ndalimin e veprimeve diskriminuese, dhe të sigurojë që respektimi i programit të monitorohet në mënyrën e duhur. Programi i pajtueshmërisë përcakton detyrimet specifike të punonjësve për përmbushjen e këtij objekti.

Personi ose organi përgjegjës për monitorimin e programit të pajtueshmërisë (zyrtari i pajtueshmërisë së operatorit të sistemit të shpërndarjes), paraqet çdo vit në ERE, një raport vjetor, i cili përcakton masat e marra në kuadër të programit të pajtueshmërisë. Ky raport publikohet.

Zyrtari i pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes është plotësisht i pavarur dhe ka qasje në të gjitha informacionet e nevojshme të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe çdo ndërmarrje bashkëpunuese, për të përmbushur detyrën e tij.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYETARI

GRAMOZ RUÇI